



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3289/Prot
2

Rrëshen, më 05 . 08 . 2026

V E N D I M

Nr. 63 datë 29. 07. 2026

PËR

**“MIRATIMIN E BINJAKËZIMIT DHE TË BASHKËPUNIMIT INSTITUCIONAL
NDËRMJET; BASHKISË MIRDITË DHE KONTESË SË NYSËS (POWIAT NYSKY),
REPUBLIKA E POLONISË”**

Në mbështetje të nenit 113, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 8, nenit 9, pika 1.5, shkronja “b”, nenit 54 dhe nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, *i ndryshuar*, në vijim të shkresës së Kontesë së Nysës nr. PR.I.0341.1.2026.IK, datë 05.05.2026, shkresës së Bashkisë Mirditë nr. 2456 prot., datë 02.06.2026, si dhe Vendimit nr. XXIX/249/2026, datë 25.06.2026, të Këshillit të Kontesë së Nysës, *Relacionin nr. 3289, datë 17.07.2026*, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, pas shqyrtimit dhe diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e binjakëzimit dhe të vendosjes së marrëdhënieve të partneritetit e bashkëpunimit institucional ndërmjet Bashkisë Mirditë, Republika e Shqipërisë, dhe Kontesë së Nysës (Powiat Nyski), Republika e Polonisë.
2. Bashkëpunimi ndërmjet palëve të zhvillohet, në mënyrë të veçantë, në fushat e politikave sociale dhe integritit komunitar; arsimit, rinisë dhe ngritjes së kapaciteteve; kulturës dhe trashëgimisë vendore, turizmit dhe promovimit rajonal, forcimit institucional dhe administratës publike, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe shëndetit publik e parandalimit.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, Z. Albert Mëlyshi, të nënshkruajë marrëveshjen / memorandumin e binjakëzimit dhe bashkëpunimit me përfaqësuesin e autorizuar të Kontesë së Nysës, në përputhje me qëllimin dhe fushat e miratuara në këtë vendim, si dhe të kryejë veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e saj.

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al


4. Zbatimi i nismave konkrete në kuadër të partneritetit do të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, kompetencat e palëve dhe mundësitë e tyre buxhetore. Çdo angazhim financiar i Bashkisë Mirditë do t'i nënshtrohet miratimeve dhe procedurave përkatëse ligjore e buxhetore të Republikës së Shqipërisë.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse të administratës së Bashkisë Mirditë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë!

SEKRETAR
Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR
Aleksandër PICA KU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3289/Prot.

Rrëshen, më 17.07.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. 69, datë 17.07.2026

PËR

**“MIRATIMIN E BINJAKËZIMIT DHE TË BASHKËPUNIMIT INSTITUCIONAL
NDËRMJET BASHKISË MIRDITË DHE KONTESË SË NYSËS (POWIAT NYSKI),
REPUBLIKA E POLONISË”**

Në mbështetje të nenit 113, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 8, nenit 9, pika 1.5, shkronja “b”, nenit 54 dhe nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; në vijim të shkresës së Kontesë së Nysës nr. PR.I.0341.1.2026.IK, datë 05.05.2026, shkresës së Bashkisë Mirditë nr. 2456 prot., datë 02.06.2026, si dhe Vendimit nr. XXIX/249/2026, datë 25.06.2026, të Këshillit të Kontesë së Nysës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Mirditë,

VENDOSI:

1. Miratimin e binjakëzimit dhe të vendosjes së marrëdhënieve të partneritetit e bashkëpunimit institucional ndërmjet Bashkisë Mirditë, Republika e Shqipërisë, dhe Kontesë së Nysës (Powiat Nyski), Republika e Polonisë.
2. Bashkëpunimi ndërmjet palëve të zhvillohet, në mënyrë të veçantë, në fushat e politikave sociale dhe integritit komunitar; arsimit, rinisë dhe ngritjes së kapaciteteve; kulturës dhe trashëgimisë vendore; turizmit dhe promovimit rajonal; forcimit institucional dhe administratës publike; mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm; si dhe shëndetit publik e parandalimit.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Mëlyshi, të nënshkruajë marrëveshjen/memorandumin e binjakëzimit dhe bashkëpunimit me përfaqësuesin e autorizuar të Kontesë së Nysës, në përputhje me qëllimin dhe fushat e miratuara në këtë vendim, si dhe të kryejë veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e saj.
4. Zbatimi i nismave konkrete në kuadër të partneritetit do të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, kompetencat e palëve dhe mundësitë e tyre buxhetore. Çdo angazhim financiar i Bashkisë Mirditë do t'i nënshtrohet miratimeve dhe procedurave përkatëse ligjore e buxhetore të Republikës së Shqipërisë.

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233 web: www.bashkiamirdite.gov.al

5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse të administratës së Bashkisë Mirditë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETAR
Gasper TOPOLLAJ

KRYETAR
Aleksandër PICA KU

Paraqiti Projektin:

Koordinator për Projektet Kabineti i Kryetarit: **Mark Ruçi**

Sektori për Integrimin Evropian dhe Projektet: P/Sek, **Gjovalin Marfana**

Drejtorja Juridike,,: P/Sek, **Lorena Gjergji**

KRYETARI
Albert MËLYSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3299 Prot.

Rrëshen, më 17.07.2026

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

**“PËR MIRATIMIN E BINJAKËZIMIT DHE TË BASHKËPUNIMIT INSTITUCIONAL
NDËRMJET BASHKISË MIRDITË DHE KONTESË SË NYSËS (POWIAT NYSKI),
REPUBLIKA E POLONISË”**

Të nderuar Këshilltarë,

1. Qëllimi i projektvendimit

Ky projektvendim synon miratimin nga Këshilli Bashkiak Mirditë të binjakëzimit dhe krijimit të një partneriteti afatgjatë ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Kontesë së Nysës në Republikën e Polonisë. Partneriteti do të krijojë një kuadër institucional për shkëmbimin e përvojave, hartimin e nismave të përbashkëta dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet institucioneve dhe komuniteteve të të dyja palëve.

2. Historiku dhe hapat e ndërmarrë

Nisma është mbështetur mbi kontaktet e krijuara gjatë vizitës së delegacionit të Kontesë së Nysës në Qarkun Lezhë dhe Bashkinë Mirditë, si dhe mbi bashkëpunimin e formalizuar ndërmjet Shkollës Profesionale “Shën Jozefi Punëtor” në Rrëshen dhe institucionit teknik e profesional CKZiU në Nysa. Kjo përvojë ka dëshmuar interesin e ndërsjellë për zgjerimin e marrëdhënieve nga niveli arsimor në një partneritet të plotë ndërinstitutional.

Me shkresën nr. PR.I.0341.1.2026.IK, datë 05.05.2026, Kontëja e Nysës mirëpriti ftesën për bashkëpunim, shprehu mbështetje aktive për partneritetin dhe propozoi fushat prioritare. Bashkia Mirditë, me shkresën nr. 2456 prot., datë 02.06.2026, konfirmoi dakordësinë me këto fusha dhe gatishmërinë për formalizimin e marrëdhënies.

Më 25.06.2026, Këshilli i Kontesë së Nysës miratoi Vendimin nr. XXIX/249/2026 “Për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet Kontesë së Nysës dhe Bashkisë Mirditë në Shqipëri”, duke shprehur zyrtarisht vullnetin për krijimin e partneritetit dhe duke ngarkuar Bordin e Kontesë së Nysës për zbatimin e vendimit.

3. Baza ligjore

Projektvendimi mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Neni 8 i ligjit njeh të drejtën e organeve vendore për të ndërmarrë nisma me interes publik vendor, ndërsa neni 9, pika 1.5, shkronja “b”, përcakton shprehimisht të drejtën e njësive të vetëqeverisjes vendore për të bashkëpunuar me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera. Vendimmarrja realizohet nga Këshilli Bashkiak në përputhje me kompetencat dhe procedurat e përcaktuara në nenet 54 dhe 55 të të njëjtit ligj.

4. Fushat prioritare të bashkëpunimit

Fusha

Përmbajtja orientuese

Politikat sociale dhe

shkëmbim përvojash në shërbimet sociale; mbështetje për të

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233 web: www.bashkiamirdite.gov.al

integrimi komunitar	moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet në nevojë; aktivizim i komuniteteve.
Arsimi, rinia dhe ngritja e kapaciteteve	shkëmbime rinore e shkollore, veprimtari ndërkulturore dhe zhvillim i aftësive gjuhësore, digjitale e qytetare.
Kultura dhe trashëgimia vendore	aktivitete të përbashkëta kulturore dhe promovim i traditave, folklorit, gastronomisë dhe trashëgimisë.
Turizmi dhe promovimi rajonal	shkëmbim përvojash për zhvillimin e turizmit vendor dhe krijim i nismave ose produkteve të përbashkëta turistike.
Forcimi institucional dhe administrata publike	shkëmbim praktikash të mira në qeverisjen vendore, digjitalizimin e shërbimeve dhe zhvillimin profesional të administratës.
Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm	edukim mjedisor, ndërgjegjësim publik dhe iniciativa për mbrojtjen e burimeve natyrore.
Shëndeti publik dhe parandalimi	promovim i stilit të shëndetshëm të jetesës dhe bashkëpunim ndërinstitucional në shëndet e parandalim.

5. Përfitimet e pritshme

Binjakëzimi pritët të zgjerojë rrjetin e partneriteteve evropiane të Bashkisë Mirditë, të krijojë mundësi për projekte të përbashkëta dhe shkëmbime profesionale, të mbështesë pjesëmarrjen e të rinjve dhe institucioneve vendore, si dhe të rrisë promovimin e Mirditës në Poloni dhe në hapësirën evropiane. Bashkëpunimi me një partner të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian përbën gjithashtu një mundësi konkrete për transferim njohurish dhe për forcimin e kapaciteteve të administratës vendore.

6. Efektet financiare dhe mënyra e zbatimit

Miratimi i binjakëzimit, në vetvete, nuk krijon detyrim financiar të menjëhershëm për buxhetin e Bashkisë Mirditë. Aktivitetet konkrete do të planifikohen rast pas rasti, në varësi të fondeve të disponueshme, programeve të Bashkimit Evropian, burimeve të donatorëve dhe mundësive buxhetore të palëve. Çdo angazhim financiar i bashkisë Mirditë do të realizohet vetëm në përputhje me legjislacionin dhe procedurat përkatëse të miratimit në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, i propozohet Këshillit Bashkiak Mirditë miratimi i projektvendimit për binjakëzimin dhe bashkëpunimin institucional me Kontenë e Nysës, si dhe autorizimi i Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes/memorandumit përkatës dhe ndjekjen e procedurave të zbatimit.

Koordinator për Projektet Kabineti i Kryetarit: **Mark Ruçi**

Spektori për Integrimin Evropian dhe Projektet: P/ Sek, **Gjovalin Marfana**

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233 web: www.bashkiamirdite.gov.al

**UCHWAŁA NR XXIX/249/2026
RADY POWIATU W NYSIE**

z dnia 25 czerwca 2026 r.

w sprawie nawiązania współpracy pomiędzy Powiatem Nyskim a Gminą Mirditë w Albanii

Na podstawie art. 12 pkt 9a ustawy z dnia 5 czerwca 1998 r. o samorządzie powiatowym (Dz. U. z 2025 r. poz. 1684 oraz z 2026 r. poz. 252) Rada Powiatu w Nysie uchwala, co następuje:

§ 1. Wyraża się wolę nawiązania partnerskiej współpracy pomiędzy Powiatem Nyskim a Gminą Mirditë w Albanii.

§ 2. Wykonanie uchwały powierza się Zarządowi Powiatu w Nysie.

§ 3. Uchwała wchodzi w życie z dniem podjęcia.

Przewodniczący Rady
Powiatu w Nysie

Piotr Bobak

VENDIM NR. XXIX/249/2026
I KËSHILLIT TË QARKUT NYSA

datë 25 qershor 2026

për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet Qarkut Nysa dhe Bashkisë Mirditë në Shqipëri

Në mbështetje të nenit 12, pika 9a, të ligjit të datës 5 qershor 1998 “Për vetëqeverisjen e qarqeve” (Fletorja Zyrtare e vitit 2025, pozicioni 1684, si dhe e vitit 2026, pozicioni 252), Këshilli i Qarkut Nysa vendos si më poshtë:

- § 1. Shprehet vullneti për vendosjen e bashkëpunimit partner ndërmjet Qarkut Nysa dhe Bashkisë Mirditë në Shqipëri.
- § 2. Zbatimi i këtij vendimi i ngarkohet Bordit Ekzekutiv të Qarkut Nysa.
- § 3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetari i Këshillit
të Qarkut Nysa

Piotr Bobak

*Përkrahur me SHqip me rjete digjitale:
Gjerdin Morfano*



Gjovalin Marfana <gjovalin1992@gmail.com>

Fwd: Request from the Municipality of Mirditë

1 message

Mark ruci <mark.ruci.1961@gmail.com>
To: Gjovalin Marfana <gjovalin1992@gmail.com>

Mon, Jul 6, 2026 at 8:31 PM

Sent from my iPhone

Begin forwarded message:

From: Starostwo Powiatowe w Nysie | Izabela Kicak <ikicak@powiat.nysa.pl>
Date: 6 July 2026 at 8:22:22 AM, CEST
To: Mark ruci <mark.ruci.1961@gmail.com>
Subject: Re: Request from the Municipality of Mirditë

Dear Mark,

I am sending you a document—a resolution of the Nysa County Council regarding the establishment of cooperation between our regions.

Best regards,
Izabela

17.04.2026 14:23 CEST Mark ruci <mark.ruci.1961@gmail.com> napisal(a):

Sent from my iPhone

Begin forwarded message:

From: Gjovalin Marfana <Gjovalin.Marfana@bashkiamirdite.gov.al>
Date: 1 April 2026 at 1:55:25 PM, CEST
To: ikicak@powiatnysa1.home.pl
Cc: Albert Melyshi <Albert.Melyshi@bashkiamirdite.gov.al>, mark.ruci.1961@gmail.com
Subject: Request from the Municipality of Mirditë

Dear Madam Izabela Kicak,

Please find attached the official request from the Municipality of Mirditë for cooperation and partnership with the Nysa District in Poland.

We kindly ask for your understanding and support in facilitating the prompt advancement of this cooperation. We believe that this partnership will contribute to strengthening mutual knowledge between our local authorities, as well as to the development of joint projects for the benefit of our respective communities.

Thank you in advance for your attention and collaboration.

Sincerely,
Gjovalin Marfana
Mark Ruçi.

Gjovalin Marfana
Përgjegjës i Njesisë së Integrimit Evropian dhe Projekteve
Head of EU Integration and Projects Unit
Bashkia Mirditë

Municipality Mirditë
+355695563624

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct

Pozdrawiam

Izabela Kicak

Naczelnik Wydziału Promocji, Przedsiębiorczości i Rynku Pracy

Starostwo Powiatowe w Nysie

ul. Piastowska 33

tel. 77 408 50 59

www.powiat.nysa.pl, [facebook.com/starostwonysa](https://www.facebook.com/starostwonysa)

2 attachments



mime-attachment.jpg
15K



NRXXIX~1.PDF
1510K